



Funded by
the European Union



Kolegji AAB
CILËSI. LEADERSHIP. SUKSESI

MANUAL

**MBI TË BËRIT BIZNES NË TREGUN E
BASHKIMIT EVROPIAN**



Autorët janë:

Prof. Ass. Dr. Pranvera Dalloshi

Prof. Ass. Dr. Mentor Borovci

Prof. Ass. Dr. Donat Rexha

“Financuar nga Bashkimi Evropian. Megjithatë, pikëpamjet dhe mendimet e shprehura janë vetëm të autorit(ve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian ose Agjencisë Ekzekutive Evropiane për Arsimin dhe Kulturën (EACEA). As Bashkimi Evropian dhe as EACEA nuk mund të mbahen përgjegjës për to”

PARATHËNIE

Projekti i titulluar “Ligjet dhe rregulloret Evropiane të Biznesit - Konkurrenca në Evropë” është një projekt i financuar nga Erasmus +. Udhëheqës i këtij projekti është Kolegji AAB, njëri ndër objektivat kryesore të këtij projekti është edhe ofrimi i një manuali të shkurtër mbi legjislacionin kryesor të Bashkimit Evropian që ndikon në aktivitetin ekonomik të bizneseve të cilat veprojnë në Kosovë, por që synojnë tregun e BE-së.

Nevoja për një Manual të tillë lindi sidomos nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit të Bashkimit Evropian (MSA) e cila është një traktat midis Bashkimit Evropian (BE) dhe një vendi joanëtar të BE-së, në këtë rast Kosovës, që synon të promovojë bashkëpunimin politik dhe ekonomik, si dhe të lehtësojë integrimin e vendit joanëtar të BE-së në një treg të vetëm.

Mundësitë ekonomike që ofron MSA për Kosovën janë të shumta. Operimi i bizneseve kosovare në tregun e përbashkët të Bashkimit Evropian i cili e mundëson zhvillimin e tregtisë së lirë në një treg të përbashkët të 27 shteteve anëtare të BE-së me afro 440 milion konsumatorë, me lëvizje të lirë të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe njerëzve ndërmjet të gjitha shteteve anëtare pa kufizime kuantitative apo kosto shtesë, është një mundësi e jashtëzakonshme për rritjen e eksportit të bizneseve kosovare në tregun e BE-së dhe njëkohësisht fuqizimin ekonomik të tyre. Përparësitë që ofron operimi në një treg të tillë janë të shumëfishta: mbrojtja e produkteve dhe ideve të bizneseve kosovare, operimi me bankat e besueshme të vendeve anëtare të BE-së, qasja në shërbimet administrative të besueshme dhe jokorruptive, qasja në incentivat, ndihmat që ofrohen për bizneset, përfitimi nga normat e ulëta të tarifave në bankat evropiane, mundësitë për të bashkëpunuar me partnerë të fuqishëm të biznesit në Evropë, mundësitë për të hapur degët e bizneseve kosovare në Evropë, qëndrimi në Kosovë por duke vazhduar biznesin edhe në tregun e BE-së etj. Duke pasur parasysh këto mundësi ekonomike që u ofrohen bizneseve kosovare, qëllimi i përgjithshëm i këtij Manuali është që t’u shërbej bizneseve kosovare të cilat kanë për qëllim të eksportojnë apo të operojnë në tregun e BE-së duke ju ofruar disa udhëzime praktike mbi mundësitë e të bërit biznes, si dhe kuadrin e nevojshëm ligjor në BE. Manuali poashtu synon të ndihmojë në përgatitjen e sektorëve të ndryshëm të ekonomisë së Kosovës në integrimin e plotë në tregun e përbashkët të Bashkimit Evropian.

Përveç tjerash, nevoja për një manual të tillë vjen edhe nga fakti se burimet legjislative të aplikueshme në BE janë të shumta dhe tejet diverse, duke filluar nga legjislacioni primar (traktatet themeluese të Bashkimit Evropian), pastaj edhe nga legjislacioni i shumtë sekondar (rregulloret, direktivat, vendimet, opinionet dhe rekomandimet) e po ashtu edhe marrëveshjet e ndryshme ndërmjet BE-së dhe vendeve të tjera, dhe kjo bënë që bizneset të cilat synojnë tregun evropian të hasin në vështirësi në kuptimin dhe zbatimin e tyre.

Synimi kryesor gjatë hartimit të këtij manuali ishte plotësia, thjeshtësia dhe kuptueshmëria ashtu që përdoruesit të mund të referohen shpejt dhe të marrin informacionin e nevojshëm për hapat kyç që duhet të ndërmarrin. Për shkak të fushës së gjerë të produkteve dhe shërbimeve të cilat i mbulon legjislacioni i BE-së, në disa raste përdoruesi është udhëzuar që të shqyrtoj legjislacionin specifik për produktin apo shërbimin përkatës.

Ky manual do ju shërbejë bizneseve kosovare si një udhëzues praktik për kuadrin ligjor dhe mundësitë e të bërit biznes në kuadër të tregut të madh të Bashkimit Evropian, duke ofruar informacionin e nevojshëm por edhe udhëzimet mbi mundësitë, kushtet dhe standardet që duhen plotësuar nga ana e bizneseve kosovare.

Për përgatitjen e këtij manuali janë përdorur burime të ndryshme, si: traktatet e Bashkimit Evropian, rregulloret dhe direktivat e BE-së, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës dhe BE-së, webfaqet zyrtare të BE-së dhe institucioneve të ndryshme të saj.

Autorët e këtij manuali janë të vetëdijshëm se duke qenë ky versioni i parë i këtij lloji mund të ketë nevojë për plotësime të mëtejme, andaj mirëpritën vërejtjet dhe sugjerimet eventuale me qëllim të përmirësimit të tij.

TABELA E PËRMBAJTJES

I. Hyrje	9
1.1 Për kë është ky manual?	9
1.2 Si ta shfrytëzoni këtë manual?	9
2. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian	10
2.1 MSA – aspektet juridike	10
2.2 MSA – aspektet ekonomike	10
2.2.1 Lëvizja e lirë e mallrave	10
2.2.2 Produktet industriale	11
2.2.3 Bujqësia dhe peshkataria	12
2.2.4 Themelimi i ndërmarrjeve, ofrimi i shërbimeve, lëvizja e kapitalit, konkurrenca dhe pronësia intelektuale	12
2.2.4 Detajet e pjesës tregtare të MSA-së	12
2.2.4.1 Koncesionet e Kosovës ndaj BE-së për produktet e peshkut	14
2.2.4.2 Obligimet e veçanta lidhur me çështjet tregtare	14
2.2.4.3 Dispozitat mbrojtëse	15
3. Të bësh biznes në Evropë	15
3.1 Themelimi i një kompanie në BE	15
3.2 Themelimi i një kompanie në BE nga qytetarët jo-europian	16
3.3 Mbrojtja e pronësisë intelektuale	17
3.3.1. Mbrojtja e patentës në BE	17
3.3.2 Mbrojtja e markës tregtare në BE	18
3.3.2.1 Procedura e aplikimit për markën tregtare	18
3.3.2.2 Regjistrimi i markës tregtare	19
3.3.2.3 Kohëzgjatja dhe rinovimi i markës tregtare	19
3.3.2.4 Dorëzimi, revokimi dhe pavlefshmëria e markës tregtare	19

3.3.2.5 Markat kolektive të BE-së	19
3.3.2.6 Shenjat e certifikimit të BE-së	20
3.3.2.7 Mbrojtja ligjore	20
3.3.3. Mbrojtja e sekretit tregtar	21
3.3.4 Mbrojtja e dizajnit	22
3.4 Taksat dhe tatimet	23
3.4.1 Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)	23
3.4.1.1 Norma e TVSH-së	23
3.4.2 Akciza	23
3.4.2.1 Kush duhet të paguajë akcizën?	24
3.4.3 Tatimet tjera	25
4. Legjislacioni i harmonizuar i Bashkimit Evropian për kërkesat e produktit	26
4.1 Standardet apo specifikimet teknike të produkteve	27
4.2 Vlerësimi i konformitetit	29
4.2.1 Shënimi CE (The Conformité Européenne) në produkt	30
4.3.2 Ekolabeli i BE-së	34
4.4 . Rregullat e origjinës së produktit	37
5 Shitja e produkteve dhe shërbimeve në BE	38
5.1 Pajtuëshmëria me standardet mjedisore	38
5.2 Rregullat e konkurrencës në Bashkimin Evropian	38
5.3 TBE dhe TFBE – dispozitat relevante për konkurrencën	39
5.5 Qasja në financat e BE-së	40
6 Ndërveprimi me klientët e BE-së	47
6.1 Mbrojtja e konsumatorëve në Bashkimin Evropian	47
6.2 . Mbrojtja e të dhënave	48

1. Hyrje

1.1. Për kë është ky manual?

Ky manual i shërben bizneseve kosovare, të cilat kanë për qëllim të eksportojnë në BE, si dhe ndihmon në përgatitjen e sektorëve të ndryshëm të ekonomisë në integrimin e plotë në tregun e përbashkët të Bashkimit Evropian. Qëllimi kryesor i këtij manuali është t'u ofrojë palëve të interesit një version konciz dhe shkurtër të koncepteve, primeve dhe praktikave të ndërveprimit me tregun dhe klientët në Bashkimin Evropian.

1.2 1.2 Si ta shfrytëzoni këtë manual

Palët e interesit mund ta shfrytëzojnë këtë manual në pjesë të ndara sipas nevojave të tyre.

Pjesa e parë e manualit është dizajnuar që të ofroj informacione të mjaftueshme në lidhje me të bërit biznes në Bashkimin Evropian, prandaj titujt dhe nëntitujt janë emëruar ashtu që të udhëzojnë lexuesin mbi përmbajtjen. Shfrytëzuesit fillimisht i është ofruar njohuri e përgjithshme mbi legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian dhe pastaj përdoruesit janë udhëzuar me hapa konkret, se si duhet të veprojnë sa i përket zbatimit të tij.

Pjesa e dytë e manualit është dizajnuar që të ofroj informacion mbi ndërveprimin me klientët e Bashkimit Evropian. Pra, bizneset kosovare mund të mos kenë seli të regjistruar në ndonjë vend të BE-së, por mund të kenë marrëdhënie biznesore me klientë të cilët janë rezident në BE.

2. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian

2.1. MSA – aspektet juridike

- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës në njërin anë Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër (këtu e tutje: MSA) është marrëveshja e parë kontraktuale në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

- MSA është nënshkruar me datën 27 tetor 2015 dhe është ratifikuar me Ligjin Nr. 05/L-069 për Ratifikimin e MSA-së, i cili ka hyrë në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, pra me datën 01 Dhjetor 2015.

- Ligji Nr. 05/L-069 është i qasshëm në linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11239>

- MSA është amandamentuar në vitin 2022 me Ligjin Nr. 08/L-165 për Ratifikimin e Vendimit Nr. 1/2022 të Këshillit të Stabilizim Asociimit BE-Kosovë për Amandamentimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike dhe Kosovës, për të zëvendësuar Protokollin III të tij në lidhje me konceptin e “produkteve të origjinës”.

- Ligji Nr. 08/L-165 është i qasshëm në linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=66174>

- Pra, MSA është një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet Kosovës dhe BE-së.

- Neni 19 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se: “Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës”.

- Andaj, pozita hierarkike e MSA-së në rendin juridik të Kosovës është e tillë që:

Të gjitha ligjet e Kosovës duhet të jenë në harmoni me MSA-në;

Në rast të konfliktit në mes të një ligji të Kosovës dhe MSA-së, epërsi ka MSA.

1.1. MSA – aspektet ekonomike

2.2.1 Lëvizja e lirë e mallrave

- BE-ja dhe Kosova gradualisht do të themelojnë një zonë të tregtisë së lirë gjatë një periudhe maksimale prej 10 vitesh, duke filluar nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje, në përputhje me këtë Marrëveshje dhe në përputhje me GATT 1994 si dhe me dispozitat e përfshira në marrëveshjet relevante me OBT-në.

2.2.2 Produktet industriale

• **Nga hyrja në fuqi e MSA-së, BE për produktet që kanë origjinë në Kosovë do të:**

Shfuqizon detyrimet doganore për importet drejt BE-së dhe ngarkesat që kanë ndikim të njëjtë;

Shfuqizon kufizimet sasiore për importet drejt BE-së dhe masat të cilat kanë efekt të njëjtë.

• Nga hyrja në fuqi e MSA-së, Kosova për produktet industriale që kanë origjinë nga BE-ja do të:

Shfuqizon tarifatat doganore për importet në Kosovë të produkteve industriale, përveç atyre të listuara në Shtojcën I;

Shfuqizon ngarkesat që kanë efekt të njëjtë me tarifatat doganore për importe në Kosovë;

Tarifatat doganore mbi importet në Kosovë të produkteve industriale me origjinë nga BE-ja të cilat janë të listuara në Shtojcën I të marrëveshjes, do të ulen në mënyrë progresive dhe do të shfuqizohen në përputhje me afatin kohor të përcaktuar në atë Shtojcë;

Shfuqizon kufizimet sasiore për importet në Kosovë të produkteve industriale si dhe masat me efekt ekuivalent.

• **BE-ja dhe Kosova, nga hyrja në fuqi e MSA-së:**

Do të shfuqizojnë çdo tarifë dhe ngarkesë doganore mbi eksportet që kanë efekt ekuivalent në tregtinë ndërmjet tyre;

Do të shfuqizojnë çfarëdo kufizimi sasior për eksportet dhe masat ekuivalente.

2.2.3 Bujqësia dhe Peshkataria

• Që nga hyrja në fuqi e MSA-së, BE:

• Do të shfuqizojë të gjitha kufizimet sasiore, dhe masat me efekt të njëjtë mbi importet e produkteve bujqësore që e kanë origjinën në Kosovë;

• Do të shfuqizojë detyrimet doganore dhe pagesat me efekt të njëjtë për importet e produkteve bujqësore që e kanë origjinën në Kosovë, (përveç disa produkteve si: gjedhe të gjalla, mish gjedhi i freskët ose i ftohur, sheqer nga kallami ose nga panxhari dhe sakarozë kimikisht e pastër në formë të ngurtë, verërat nga rrushi i freskët, përfshirë verërat e fortifikuara etj.)

• Që nga hyrja në fuqi e MSA-së, Kosova:

• Do të shfuqizojë të gjitha kufizimet sasiore dhe masat me efekt të njëjtë mbi importet e produkteve bujqësore që e kanë origjinën në BE;

• Do të shfuqizojë tarifatat doganore të aplikueshme për importet e produkteve të caktuara bujqësore që e kanë origjinën në BE, përveç disa produkteve të listuara në shtojcat e marrëveshjeve.

2.2.4 Themelimi i ndërmarrjeve, ofrimi i shërbimeve, lëvizja e kapitalit, konkurrenca dhe pronësia intelektuale sipas MSA-së

• Ndërmarrjet e Kosovës, degët dhe filialet e tyre do të mund t'i themelojnë dhe të veprojnë në territorin e BE-së duke u trajtuar në mënyrë të njëjtë sikur ndërmarrjet e BE-së.

• E njëjta e drejtë do të vlej anasjelltas edhe për ndërmarrjet e BE-së që do të vendosen dhe do të veprojnë në territorin e Kosovës.

• Ndërmarrjet e BE-së do të kenë të drejtë për të përdorur dhe marrë me qira pasuri të patundshme në Kosovë.

• Pas pesë viteve nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes, ndërmarrjet e BE-së do ta kenë gjithashtu të drejtën e përvetësimit dhe gëzimit e të drejtave të pronësisë mbi pasuritë e patundshme sikurse ndërmarrjet kosovare në BE.

• Nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes, Kosova dhe BE do të sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit lidhur me investimet e drejtpërdrejta nga ndërmarrjet e krijuara në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm dhe investimeve të bëra në përputhje me MSA-në, si dhe likuidimin ose riadhesimin e këtyre investimeve dhe të çdo përfitimi që rrjedh prej tyre.

- Brenda pesë viteve nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes, Kosova duhet të ofroj trajtim të barabartë me shtetasit e Kosovës për shtetasit e BE-së që blejnë pasuri të patundshme në territorin e saj.

- Konkurrenca në treg - ku ndalohen të gjitha praktikatat dhe marrëveshjet që parandalojnë, kufizojnë ose pengojnë konkurrencën përfshirë edhe kontrollin dhe monitorimin e ndihmës shtetërore.

- Ndërmarrjet publike të cilat kanë status të ofrimit të shërbimeve të interesit të përgjithshëm, brenda tre viteve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes duhet të zbatojnë rregullat e konkurrencës në harmoni me parimet e Traktatit për Funksionimin e BE-së deri në masën që nuk pengon ofrimin e këtyre shërbimeve.

- Mbrojtja efektive e pronësisë intelektuale - Kosova brenda pesë viteve nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes duhet të sigurojë nivel të ngjashëm të mbrojtjes së pronësisë intelektuale, industriale dhe komerciale me atë të BE-së.

- Fillimi i dhënies së kontratave përmes prokurimit publik bazuar në parimet e reciprocitetit dhe mosdiskriminimit si objektiv i dëshiruar i të dy palëve.

- Ndërmarrjet e Kosovës do të kenë trajtim të barabartë në procedurat për dhënie të kontratave në BE.

- Ndërsa, në Kosovë ndërmarrjet e Kosovës do të jenë të favorizuara në çmimin e ofertuar si vijon:

- 15% deri në fund të vitit të dytë;

- 10% deri në fund të vitit të tretë;

- 5% deri në fund të vitit të katërt;

- 0% deri në fund të vitit të pestë.

- 0% until the end of the fifth year.

2.2.4 Detajet e pjesës tregtare të MSA-së

- Të gjitha produktet industriale dhe bujqësore (përveç mishit, verës dhe disa produkteve të sheqerit) të Kosovës do të eksportohen në BE pa tarifë doganore.

- Sidoqoftë, janë të vendosura kuota të caktuara, si për shembull tarifa doganore në BE nuk vlen deri në volumn prej 15 tonë për vit, për peshkun troftë. Kuota për krap është 20 tonë në vit. Pas kësaj sasive, aplikohet tarifa doganore e BE-së.

- Kuota e eksportit të verës është rritur nga 20,000 hektolitra në 50,000 hektolitra.

- Kosova do të shfuqizojë tarifatat doganore për një numër të konsiderueshëm të produkteve industriale me hyrjen në fuqi të MSA-së. Këto produkte nuk prodhohen në Kosovë dhe ne nuk kemi kapacitete për prodhimin e tyre.

- Ndërsa një numër i caktuar i produkteve do të liberalizohen gradualisht brenda një periudhe prej 5 (pesë) vitesh dhe një numër brenda një periudhe prej 7 (shtatë) vitesh nga hyrja në fuqi e MSA-së.

- Kosova, që nga hyrja në fuqi e MSA-së, do të shfuqizojë tarifatat doganore për rreth 50% të produkteve bujqësore nga BE-ja.

- Në marrëveshje nuk janë përfshirë dhe kanë qenë të panegociuara 14 (katërmëdhjetë) produkte, që do të thotë se tarifa kosovare do të mbetet e njëjtë (10%) për ato produkte (që përfshijnë kryesisht produkte të qumështit, krem, jogurt, patate, mollë, verë).

- Ndërsa, një numër i produkteve bujqësore do të jenë të mbrojtura me tarifë për 7 (shtatë) vjet ose 10 (dhjetë) vjet, domethënë do të ketë reduktim gradual të tarifës doganore.

2.2.4.1 Koncesionet e Kosovës ndaj BE-së për produktet e peshkut

- Me hyrjen në fuqi të MSA-së, Kosova do të shfuqizojë tarifën doganore për 487 produkte të peshkut.

- Sa i përket troftës, tarifa do të hiqet gradualisht për një periudhë 7 (shtatë) vjeçare, ndërsa për krap gradualisht për 5 (pesë) vite.

2.2.4.2 Obligimet e veçanta lidhur me çështjet tregtare

- Ngirja e masave doganore “Standstill” – MSA parandalon të dy anët që të marrin masa të reja doganore apo të rrisin ato ekzistuese.

- Ndalesa e diskriminimit fiskal – MSA parandalon të dy anët që të marrin masa të natyrës së brendshme fiskale të cilat në çfarëdo mënyre diskriminojnë produkte të palës tjetër.

- E drejta për marrëveshje të tjera doganore – MSA njeh marrëveshje tjera doganore të dy palëve apo mundësinë e lidhjes së marrëveshjeve të tjera, përderisa ato nuk përbëjnë shkelje të dispozitave të MSA-së.

- Antidamping dhe subvencionet – MSA parasheh të drejtën të merr masa tregtare kundër konkurrencës jo të drejtë, në harmoni me rregullat e Organizatës Botërore të Tregtisë.

- Monopolet shtetërore të karakterit komercial – Me hyrjen në fuqi të MSA-së, Kosova do të sigurojë trajtim të barabartë të furnizimit dhe shitjes së mallrave nga ana e monopoleve shtetërore të karakterit komercial.

- Kufizimet e lejuara – marrëveshja lejon vendosjen e kufizimeve në zbatimin e dispozitave të MSA-së në rrethana të veçanta në bazë të kërcënimit ndaj sigurisë dhe interesit publik, moralit publik, mbrojtjes së jetës së qytetarëve, kafshëve dhe bimëve, etj.

2.2.4.3 Dispozitat mbrojtëse

- MSA lejon marrjen e masave mbrojtëse në ato raste kur tregtia me një apo më shumë produkte shkakton:
- Dëmtim serioz të industrisë së caktuar ose çrregullim për ndonjë sektor të ekonomisë së një pale;
- Ndërhyrje në ekonomi, të cilat mund të kenë pasoja serioze në kuadër të regjionit të një pale.

3. Të bësh biznes në Evropë

- Ky seksion ofron informacion konkret të disa fushave të ndërveprimit me tregun e Bashkimit Evropian. Çështjet si themelimi i një kompanie në BE, markat tregtare, taksat dhe tatimet, mbrojtja e konsumatorit, rregullat e konkurrencës, kërkesat për produkte siç janë: standardet e harmonizuara, shenja e konformitetit CE, kërkesat për etiketim, shënjimi si dhe riciklimi dhe menaxhimi i mbetjeve janë të prezantuara hap pas hapi.

3.1. Themelimi i një kompanie në BE

- Neni 54 i Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian (TFBE) parashikon që subjektet duhet të plotësojnë dy kërkesa në mënyrë që të mund të konsiderohen si “Kompani”:
- **Së pari**, subjekti duhet të jetë i themeluar në përputhje me ligjin e një Shteti Anëtar të BE-së dhe të ketë zyrën e tij të regjistruar, zyrën qendrore ose vendin kryesor të biznesit brenda BE-së. Subjekti duhet që nga aspekti juridik, të ketë pasurinë e ndarë, nga ajo e pronarëve të tij.
- **Së dyti**, neni 54 i TFBE-së përcakton se shoqëria apo entiteti duhet të jetë fitimprurës.
- Për të filluar një kompani të re ose për të zgjeruar biznesin në një vend tjetër të BE-së, secili duhet të dijë rregullat dhe kërkesat në vendet anëtare përkatëse.
- Të interesuarit për të hapur një kompani në një vend të caktuar të BE-së duhet të shqyrtojnë kërkesat dhe të kontaktojnë **Pikat Përkatëse Kombëtare të Kontaktit (National Contact Point)**. Pikat e kontaktit për vendet anëtare të BE-së mund të gjenden në linkun: https://single-market-economy.ec.europa.eu/single-market/services/directive/points-single-contact_en

3.2 Themelimi i një kompanie në BE nga qytetarët joevropian

- Qytetarët joevropian të cilët synojnë të themelojnë një biznes në BE duhet:
- Të marrin lejen e banimit - në shtetin ku kanë ndërmend të hapin biznesin e tyre.
- Të dorëzojnë një plan biznesi - për të qenë në gjendje të marrim një leje banimi me qëllim të fillimit të një biznesi. Plani i biznesit shqyrtohet nga autoritetet e punës dhe emigracionit për të përcaktuar nëse ai u përshkruan nevojave ekonomike të vendit. Leje qëndrimi do të aprovohet vetëm nëse vetëpunësimi ose aktiviteti i biznesit ka të ngjarë të japë një kontribut të rëndësishëm për: ekonominë, kulturën dhe/ose shkencat e vendit në të cilin aplikohet. Në thelb, plani i biznesit duhet të tregojë se do të bëhen investime dhe do të ofrohen shërbime për të cilat ka nevojë në vendin e interesit.
- Të regjistrojnë biznesin pranë autoriteteve lokale - duhet ditur se juridiksionet dhe agjencitë përgjegjëse qeveritare ndryshojnë nga shteti në shtet (siç është shpjeguar më lartë).
- Të marrin një numër identifikimi të taksave - të biznesit dhe të regjistruhen në administratën përkatëse të sigurimeve shoqërore.
- Të zgjedhin një agjent të regjistruar - një person ose një biznes që do të pranojë dokumentet tatimore dhe ligjore në emër të biznesit.
- Të interesuarit për të hapur një biznes në BE, gjithashtu, duhet të dinë se:
- Disa shtete anëtare të BE-së nuk e specifikojnë se sa vende pune duhet të krijojë biznesi për t'ia lejuar që të operojë, ndërsa ka edhe vende të cilat kërkojnë një numër të caktuar të vendeve të punës.
- Shtetet anëtare të BE-së kanë kërkesa të ndryshme për kapital minimal.
- Taksat dhe tatimet ndryshojnë nga shteti në shtet.

3.3. Mbrojtja e pronësisë intelektuale

• Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) në nenin 118 ka përcaktuar se: *“Në kuadër të krijimit dhe funksionimit të tregut të brendshëm, Parlamenti Evropian dhe Këshilli, duke vepruar në përputhje me procedurën e zakonshme legjislative, do të vendosin masa për krijimin e të drejtave evropiane të pronësisë intelektuale për të ofruar mbrojtje uniforme të pronësisë intelektuale në të gjithë Bashkimin dhe për krijimin e autorizimit të centralizuar në mbarë Bashkimin për aranzhimet e koordinimit dhe mbikëqyrjes”.*

• Në kuadër të BE-së, është e garantuar dhe e mbrojtur e drejta e pronësisë intelektuale. Kjo domethënë se, duke mbrojtur shpikjen tuaj, si për shembull një produkt të ri, ju bëheni personi i vetëm që keni të drejtën për ta përdorur ose riprodhuar atë. Në një rast të tillë, personat e tjerë nuk mund ta kopjojnë ose riprodhojnë produktin e tillë pa lejen tuaj.

• Posedimi i një patente ose marke tregtare, mund të rrisë vlerën e biznesit tuaj në treg. Për informacione të mëtejme, mund t’i referoheni Zyrës së Pronësisë Intelektuale të Bashkimit Evropian në linkun: <https://euipo.europa.eu/ohimportal/en/online-services/ideas-poëered-for-business>

3.3.1 . Mbrojtja e patentës në BE

• Duke e regjistruar patentën tuaj, ju gëzoni mbrojtjen e saj për një periudhë të kufizuar e cila zakonisht është 20 vite. Mbrojtja nënkupton se personat e tjerë nuk mund ta bëjnë, përdorin, ofrojnë për shitje, ta shesin ose importojnë produktin ose një proces të bazuar në shpikjen tuaj të patentuar.

• Bizneset kosovare mund t’i japin dikujt tjetër leje të përkohshme për të përdorur shpikjen nëpërmjet një marrëveshjeje, licence për patentë, ose t’ia shesin patentën dikujt tjetër. Por, nuk mund të rinovoni një patentë pas skadimit të saj.

• Ju mund të kërkonit mbrojtje të patentës vetëm në një vend evropian nëse e regjistroni patentën në nivel nacional, duke iu qasur autoriteteve nacionale për mbrojtjen e patentës. Kontaktet e autoriteteve për patentim të shteteve anëtare mund t’i gjeni në linkun: <https://www.epo.org/service-support/useful-links/national-offices.html>

• Ju mund të kërkonit edhe mbrojtjen e patentës në nivel të BE-së, duke e regjistruar patentën tuaj në Zyrën Evropiane të Patentave. Për më shumë të dhëna, mund të qaseni në faqen zyrtare të Zyrës Evropiane të Patentave në linkun: <https://www.epo.org/index.html>

3.3.2 . Mbrojtja e markës tregtare në BE

• Markat tregtare janë të mbrojtura në nivel të Bashkimit Evropian.

• Rregullorja (BE) 2017/1001 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 qershor 2017 për markën tregtare të Bashkimit Evropian përcakton rregullat dhe kushtet në mbarë BE-në, për dhënien e një marke tregtare të BE-së. Rregullorja është e qasshme në linkun: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32017R1001>

• Sipas kësaj rregulloreje, *çdo person ose kompani, duke përfshirë autoritetet e krijuara sipas ligjit publik, mund të marrë një markë tregtare të BE-së përmes regjistrimit*. Ajo mund të përbëhet nga çdo shenjë, në veçanti fjalë (përfshirë emrat personal), dizajne, shkronja, numra dhe formën e mallrave ose të paketimit të tyre, me kusht që shenja të tilla të jenë në gjendje të:

• Bëjnë dallimin e mallrave ose shërbimeve të një biznesi nga ato të një tjetri; dhe

• Bëhen pjesë e regjistrimit të markave tregtare në mënyrë të tillë që publiku dhe autoritetet ta dinë saktësisht lëndën që mbrohet.

3.3.2.1 Të drejtat e pronarit të markës tregtare

• Pronarit i jepet e drejta ekskluzive, e cila ja ndalon palëve të treta të përdorin ndonjë nga sa vijon për qëllime komerciale:

• Çdo shenjë që është identike me markën tregtare të BE-së në lidhje me mallrat ose shërbimet që janë identike me ato për të cilat është regjistruar marka tregtare e BE-së;

• Çdo shenjë ku ekziston mundësia e ngatërimit me një markë tjetër tregtare;

• Çdo shenjë që është identike ose e ngjashme me markën tregtare të BE-së në lidhje me mallrat ose shërbimet që nuk janë të ngjashme me ato për të cilat është regjistruar marka tregtare e BE-së, ku përdorimi i kësaj shenje përfiton nga reputacioni dhe karakteri dalues i markës tregtare.

• Megjithatë, pronari i markës tregtare të BE-së nuk mund t’i ndalojë palët e treta të përdorin sa vijon për qëllime komerciale:

• Emrin ose adresën e vetë pronarit;

• Tregues në lidhje me karakteristikat e mallrave ose shërbimeve si lloji, cilësia ose sasia;

• Markën tregtare ku është e nevojshme të tregohet qëllimi i synuar i një produkti ose shërbimi, si aksesorë ose pjesë këmbimi.

3.3.2.2 Procedura e aplikimit për markën tregtare

- Aplikantët duhet të paraqesin aplikimin për një markë tregtare të BE-së në Zyrën e Pronësisë Intelektuale të Bashkimit Evropian (EUIPO). Aplikacioni duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:
- Kërkesën për regjistrimin e një marke tregtare të BE-së;
- Informacionin që identifikon aplikantin;
- Listën e mallrave ose shërbimeve për të cilat kërkohet regjistrimi;
- Një përfaqësim të markës tregtare.
- Aplikantët duhet të paguajnë gjithashtu një tarifë aplikimi. Tarifa e aplikimit duhet të paguhet brenda 1 muaji nga data e depozitimit - data në të cilën dokumentet janë dorëzuar në EUIPO.

3.3.2.3 Regjistrimi i markës tregtare

- Pasi aplikimi të jetë depozituar, EUIPO do të shqyrtojë nëse i plotëson të gjitha kushtet për dhënien e një marke tregtare të BE-së.
- Publikimi i aplikacionit do të lejojë palët e tre të kundërshtojnë dhënien e markës tregtare dhe që ta bëjnë këtë në bazë të të drejtave të mëparshme, në procedurat e kundërshtimit.
- Nëse aplikacioni i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara dhe nuk paraqitet apo nuk pranohet asnjë kundërshtim, atëherë regjistrimi i markës tregtare publikohet.

3.3.2.4 Kohëzgjatja dhe rinovimi i markës tregtare

- Markat tregtare të BE-së regjistrohen për një periudhë 10 (dhjetë) vjeçare nga data e paraqitjes së aplikimit.
- Regjistrimi mund të rinovohet për periudha të mëtejme prej 10 vitesh.
- Aplikimi për rinovim duhet të dorëzohet 6 muaj përpara përfundimit të vlefshmërisë së regjistrimit.

3.3.2.5 Dorëzimi, revokimi dhe pavlefshmëria e markës tregtare

- Një markë tregtare e BE-së mund të dorëzohet në lidhje me disa ose të gjitha mallrat ose shërbimet për të cilat është regjistruar.
- Të drejtat e pronarit gjithashtu mund të revokohen nëse:

- Marka tregtare nuk i është nënshtruar përdorimit të mirëfilltë në BE për 5 vjet;
- Marka tregtare është bërë emër i zakonshëm për një produkt ose shërbim;
- Marka tregtare mund të mashtrojë publikun në lidhje me natyrën, cilësinë ose origjinën gjeografike të mallrave ose shërbimeve.
- Rregullorja gjithashtu përcakton arsyet për pavlefshmërinë e markës tregtare. Këto arsye përfshijnë për shembull, rastet kur aplikanti ka vepruar me keqbesim gjatë paraqitjes së aplikimit për markën tregtare.

3.3.2.6 Markat kolektive të BE-së

- Kur depozitohet një aplikim për regjistrim, është e mundur të përcaktohet një markë tregtare e BE-së si kolektive. Të autorizuar të depozitojnë marka kolektive të BE-së janë shoqatat e:
- Prodhuesve;
- Furnizuesve të shërbimeve;
- Tregtarëve;
- Personave juridikë të rregulluar nga e drejta publike.

3.3.2.7 Shenjat e certifikimit të BE-së

Është gjithashtu e mundur të caktohet një markë tregtare e BE-së si markë certifikimi. Pronari i një marke të tillë vërteton **materialin, mënyrën e prodhimit të mallrave ose kryerjen e shërbimeve, cilësinë, saktësinë ose karakteristika të tjera** (duke përfshirë origjinën gjeografike) të mallrave dhe shërbimeve të certifikuar.

3.3.2.8 Mbrojtja ligjore:

- Rregullorja (BE) Nr. 1215/2012 zbatohet për procedurat në lidhje me markat tregtare të BE-së dhe aplikimet për markat tregtare të BE-së.

- Vendet anëtare të BE-së duhet të caktojnë 'gjykatat kompetente për markat tregtare'. Këto gjykata kanë juridiksion ekskluziv në të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me shkeljen dhe vlefshmërinë e markave tregtare të BE-së.

- Për më shumë të dhëna rreth mbrojtjes së markës tregtare mund të qaseni në faqen zyrtare të Zyrës së Pronësisë Intelektuale në BE në linkun: <https://euipo.europa.eu/ohim-portal/en/web/guest/apply-now>

3.3.3 . Mbrojtja e sekretit tregtar

- Nëse zotëroni informacion të vlefshëm mbi teknologjinë ose për çdo aspekt tjetër të biznesit tuaj, mund ta mbroni atë si sekret tregtar nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- informacioni nuk dihet as nga publiku i gjerë dhe as nga ekspertët e sektorit në fjalë;

- informacioni ka vlerë tregtare;

- ju keni ndërmarrë hapa për ta mbajtur informacionin sekret: për shembull, ju e mbani atë në ruajtje të sigurt dhe keni nënshkruar marrëveshje moszbulimi me këdo që ka qasje në të ose me të cilin e keni ndarë informacionin.

- Sekretet tregtare mund të përfshijnë një sasi të madhe informacioni dhe njohurish që nuk janë të mbrojtura ose nuk mund të mbrohen siç duhet nëpërmjet patentave, si p.sh:

- shpikjet në fazat e hershme;

- proceset e prodhimit;

- listat e furnitorëve dhe klientëve.

- Informacioni i mbrojtur nga sekretet tregtare mund të jetë strategjik për një kohë të gjatë, si recetat ose përbërjet kimike, ose për periudha më të shkurtra, siç janë rezultatet e një studimi marketingu, emri i markës, çmimi dhe data e lançimit/nxjerrjes së një produkti të ri ose çmimi, të ofruara në një procedurë tenderimi.

- Për më shumë informacione për mbrojtjen e sekretit tregtar të BE-së mund të qaseni në faqen e mbrojtjes së sekretit zyrtar në linkun: <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/5f1c6d8a-f015-11eb-a71c-01aa75ed71a1/language-en/format-PDF/source-227370609>

3.3.4 . Mbrojtja e dizajnit

- Mbrojtja e dizajnit ju garanton të drejtën ekskluzive për të përdorur një dizajn, i cili përfshin prodhimin, ofrimin, nxjerrjen në treg, importimin, eksportimin ose përdorimin e produktit në të cilin dizajni juaj është përfshirë ose në të cilin është aplikuar. Nëse jepni autorizimin tuaj, palët e treta mund të përdorin dizajnin tuaj në produktet e tyre.

- Për të siguruar mbrojtje, dizajni juaj duhet të regjistrohet. Ju mund të kërkon mbrojtjen vetëm në një vend anëtar të BE-së, duke e regjistruar dizajnin tuaj në zyrën e pronësisë intelektuale të atij vendi anëtar të BE-së. Në këtë rast mund të qaseni në linkun në vijim për të kontaktuar me ndonjërin nga zyrat nacionale të shteteve anëtare të BE-së: https://www.tmdn.org/network/who_is_participating

- Ndërsa, për të siguruar mbrojtje në nivel të BE-së, ju keni dy mundësi: ose të mbroni dizajnin tuaj në Zyrën e Pronësisë Intelektuale të Bashkimit Evropian (EUIPO) përpara se ta komercializoni atë dhe të merrni një dizajn të regjistruar të Komunitetit (RCD), ose si alternativë, ta komercializoni atë drejtpërdrejt pa regjistrim duke u mbështetur në atë që njihet si dizajni i paregjistruar i Komunitetit (UCD).

- Që të dy opsionet e mbrojtjes së dizajnit (RCD apo UCD) ofrojnë mbrojtjen e mëposhtme:

- Prodhimi i një produkti që përfshin një dizajn të mbrojtur (ose për të cilin dizajni është aplikuar) pa pëlqimin e pronarit të tij do të konsiderohet i paligjshëm.

- Vendosja e një produkti në treg që përfshin dizajnin e mbrojtur (ose për të cilin dizajni është aplikuar) pa pëlqimin e pronarit të tij do të konsiderohet i paligjshëm.

- Ofrimi i një produkti për shitje që përfshin një dizajn të mbrojtur pa pëlqimin e pronarit të tij do të konsiderohet i paligjshëm.

- Tregtimi i një produkti që përfshin dizajnin e mbrojtur pa pëlqimin e pronarit të tij do të konsiderohet i paligjshëm.

- Importimi-eksportimi i një produkti që përfshin dizajnin e mbrojtur pa pëlqimin e pronarit të tij do të konsiderohet i paligjshëm.

- Opsionet e mbrojtjes së dizajnit dallojnë për nga kohëzgjatja e mbrojtjes së tyre kështu që:

- Një dizajn i regjistruar i Komunitetit (RCD) është fillimisht i vlefshëm për 5 (pesë) vjet nga data e depozitimit dhe mund të rinovohet në blloqe prej 5 (pesë) vitesh deri në një maksimum prej 25 (njëzetepesë) vitesh.

- Një dizajn i regjistruar i Komunitetit (RCD) është fillimisht i vlefshëm për 5 (pesë) vjet nga data e depozitimit dhe mund të rinovohet në blloqe prej 5 (pesë) vitesh deri në një maksimum prej 25 (njëzetepesë) vitesh.

- Një dizajni të paregjistruar të Komunitetit (UCD) i jepet mbrojtje për një periudhë prej tre vjetësh nga data në të cilën dizajni është vënë për herë të parë në dispozicion të publikut brenda territorit të Bashkimit Evropian. Pas tre vjetësh, mbrojtja nuk mund të zgjatet.

- Për më shumë informacione në lidhje me mbrojtjen e dizajnit në Bashkimit Evropian, mund të qaseni në linkun: <https://euipo.europa.eu/ohimportal/en/designs-in-the-eu-ropean-union>

3.4. Taksat dhe tatimet

- BE-ja nuk ka një rol të drejtpërdrejtë në mbledhjen e taksave apo përcaktimin e normave tatimore. Bizneset që operojnë në tregun e Bashkimit Evropian duhet të jenë në përputhje me legjislacionin tatimor të shteteve anëtare të BE-së.

- Për shkak të politikave tatimore të ndryshme në shtetet anëtare të BE-së, është e rëndësishme të identifikoni legjislacionin tatimor në vendet anëtare të BE-së që keni interes, duke përfshirë normat tatimore, afatet e paraqitjes dhe çdo kërkesë tjetër.

- Pajtueshmëria me legjislacionin tatimor të shteteve anëtare të BE-së është një aspekt thelbësor i të bërit biznes në BE prandaj, janë disa gjëra kryesore që duhet t'i dini në vijim.

3.4.1 . Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH): është një taksë konsumi që zbatohet për mallrat dhe shërbimet në BE. Është e rëndësishme të kuptoni rregulloret e TVSH-së në vendet ku biznesi operon dhe të regjistroheni për TVSH nëse është e nevojshme.

- Çdo shtet anëtar i BE-së është përgjegjës për vendosjen e tarifave të veta, por kjo tarifë sipas Direktivës nr. 2006/112/KE – Sistemi i përbashkët i Bashkimit Evropian për tatimin mbi vlerën e shtuar, nuk mund të jetë më e ulët se sa norma standarde prej 15%.

- Një ose dy tarifa të reduktuara mund të aplikohen për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve specifike (bazuar në listën e specifikuar në Aneksin III të Direktivës së TVSH-së), por normat e reduktuara nuk mund të jenë më pak se 5%.

3.4.2 . Akciza

- Akciza në BE aplikohet për shitjen ose përdorimin e mallrave të tilla si *alkooli dhe pijet alkoolike, produktet e duhanit, produktet energjetike dhe energjia elektrike*.

3.4.2.1 Normat e akcizës

- Vendet kanë të drejte të vendosin norma të reduktuara të cilat nuk mund të vendosen më shumë se 50 % nën normën standarde kombëtare të akcizës.

- Taksimi i produkteve energjetike dhe energjisë në BE rregullohet nga Direktiva e Këshillit nr. 2003/96/KE e datës 27 Tetor 2003.

- Direktiva 2014/40/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 3 Prill 2014 për përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të Shteteve Anëtare në lidhje me prodhimin, prezantimin dhe shitjen e duhanit dhe produkteve të ngjashme është direktiva në fuqi për taksimin e produkteve të duhanit.

3.4.2.2 Kush duhet të paguajë akcizën

- Mallrat i nënshtrohen detyrimit të akcizës kur njeri nga rastet e mëposhtme ndodh në BE:

- prodhimi ose nxjerrja;

- importimi, legal ose ilegal.

- Akciza ngarkohet në kohën dhe në vendin ku mallrat e akcizës lëshohen për konsum në shtetin anëtar.

- Akciza mund të paguhet nga:

- Personi ose biznesi i cili ofron depon në mënyrë të autorizuar në vendin ku prodhohen, përpunohen, magazinohen, dërgohen ose merren produktet e akcizës.

- Dërguesi, marrësi, transportuesi ose pala e tretë që siguron një garanci lëvizjeje -

personi që importon mallrat.

3.4.3 Tatimet tjera

- Tatimet tjera që aplikohen në BE janë:

- Tatimi mbi të ardhurat e korporatave: Bizneset që operojnë në BE i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat e korporatave. Normat e tatimit ndryshojnë sipas shteteve, prandaj është e rëndësishme të hulumtoni për këto norma në vendet me interes.

- Tatimi në burim: Tatimi në burim është një taksë që zbritet nga pagesat e bëra ndaj jorezidentëve. Bizneset që kryejnë pagesa për jorezidentët, si dividendë ose honorare, mund t'i nënshtrohen tatimit në burim.

- Çmimi i transferimit: Çmimi i transferimit i referohet çmimit të mallrave dhe shërbimeve brenda një kompanie që operon në shumë vende. BE ka rregulla strikte të çmimeve të transferimit, për të parandaluar kompanitë të shmangin tatimin duke zhvendosur fitimet në vendet me norma tatimore më të ulëta.

- Pajtueshmëria me kërkesat e raportimit tatimor: Bizneset që operojnë në BE duhet të përmbushin kërkesat lokale të raportimit tatimor, duke përfshirë paraqitjen e deklarave tatimore dhe kryerjen e pagesave tatimore në kohë. Mosrespektimi mund të rezultojë në dënime dhe gjoba.

- Traktatet tatimore: BE-ja ka nënshkruar traktate tatimore me disa vende për të shmanjur taksimin e dyfishtë. Është e rëndësishme të kuptohen traktatet tatimore ndërmjet vendeve ku biznesi operon.

- Kërkoni këshilla profesionale: Rregulloret tatimore në BE mund të jenë komplekse dhe ndryshojnë sipas shtetit. Rekomandohet të kërkoni këshilla profesionale nga ekspertët tatimor për të siguruar përputhjen me rregulloret lokale tatimore.

4. Legjislacioni i harmonizuar i Bashkimit Evropian për kërkesat e produktit

- Pavarësisht nga origjina e tyre, produktet të cilat vihen në dispozicion në tregun e Bashkimit Evropian duhet të jenë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm të harmonizimit të BE-së.

- Termi “Kërkesat e produktit” i referohet kushteve thelbësore që produktet duhet të plotësojnë për të hyrë në tregun e Bashkimit Evropian.

- Kërkesat e produktit mund të aplikohen për vetë produktin, procesin e prodhimit apo performancën e tij. Këto kërkesa kanë të bëjnë me përcaktimin e karakteristikave specifike që duhet të ketë një produkt. Këto kërkesa mund të jenë për sa i përket:

- Dizajnit;

- Etiketimit;

- Shënjitimit;

- Ambalazhit;

- Funksionalitetit ose performancës.

- Për të vendosur një produkt në tregun e Bashkimit Evropian, prodhuesi duhet të ndër-marrë hapat e mëposhtëm:

- Të kryejë vlerësimin e zbatueshëm të konformitetit;

- Të hartoj dokumentacionin teknik të kërkuar;

- Të hartojë deklaratën e konformitetit;

- Të shoqërojë produktin me udhëzime dhe informacione sigurie;

- Të plotësojë kërkesat e gjurmueshmërisë;

- Të vendos shenjën e konformitetit kur është e nevojshme (shënjin CE dhe kur është e nevojshme shenja të tjera);

- Të sigurohet se ekzistojnë procedura që prodhimi në seri të mbetet në konformitet;

- Aty ku është e nevojshme, të certifikoj produktin apo sistemin e cilësisë.

- Ofruesit e produkteve dhe shërbimeve në Bashkimin Evropian, ndër të tjera duhet të konsultojnë rregulloret e mëposhtme:

•Rregullorja (BE) Nr. 1025/2012 mbi standardizimin

•Rregullorja (KE) Nr. 765/2008 e përcaktimit të kërkesave për akreditim dhe mbikëqyrje të tregut në lidhje me marketingun e produkteve dhe shfuqizimit të Rregullores (KEE) Nr. 339/93

•Rregullorja (BE) 2019/1020 mbi mbikëqyrjen e tregut dhe përputhshmërinë e produkteve (amendamentin e disa pjesëve të Rregullores (KE) Nr. 765/2008)

4.1 Standards or technical specifications of products

• Standardet janë udhëzime vullnetare që ofrojnë specifikime teknike për mallra, shërbime dhe procese të caktuara. Rregullorja (BE) Nr. 1025/2012 ofron një bazë ligjore për përdorimin e standardeve evropiane për produktet dhe shërbimet, për të identifikuar specifikimet teknike të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) dhe për të financuar procesin e standardizimit evropian. Duke ndjekur standardet e BE-së, prodhuesit mund të jenë të sigurt që produktet e prodhuara plotësojnë çdo kërkesë ligjore të zbatueshme.

• Prodhuesit janë përgjegjës për të kontrolluar nëse produktet e tyre përmbushin kërkesat e BE-së për sigurinë, shëndetin dhe mbrojtjen e mjedisit. Është përgjegjësi e prodhuesit të kryejë vlerësimin e konformitetit, të krijojë dosjen teknike, të lëshojë deklaratën e konformitetit të BE-së dhe të vendosë markimin CE në një produkt kur është e aplikueshme. Vetëm atëherë produkti mund të tregtohet në tregun e Zonës Ekonomike Evropiane (ZEE). Përgjegjësitë e prodhuesit vlejnë edhe për çdo person fizik ose juridik që monton, paketon, përpunon ose etiketon produktet e gatshme dhe i vendos ato në treg me emrin ose markën e tij tregtare.

Sipas legjislationit të BE-së, **prodhuesi** është çdo person fizik ose juridik që është përgjegjës për projektimin ose prodhimin e një produkti dhe e vendos atë në treg nën emrin ose markën e tij tregtare.

4.1.1 Cili është qëllimi i rregullores?

• Synon të modernizojë dhe përmirësojë standardizimin, i cili luan rol udhëheqës në tregun e vetëm të BE-së, duke përshkruar:

•Se si funksionon procesi i përcaktimit të standardeve të BE-së

•Se si punojnë së bashku organizatat e ndryshme të përfshira në këtë proces (si në nivel të BE-së ashtu edhe në nivel kombëtar)

•Se si kërkohet të thjeshtësojë dhe përshtatë kuadrin legjislativ për të pasqyruar zhvillimet më të fundit dhe sfidat e ardhshme.

•Sipas kësaj rregulloreje zbatohen përkufizimet e mëposhtme për të kuptuar se çfarë do të thotë “standard”:

•“Standard” do të thotë një specifikim teknik, i miratuar nga një organ standardizimi, për aplikim të përsëritur ose të vazhdueshëm, me të cilin pajtueshmëria nuk është e detyrueshme dhe të cilat mund të jenë standarde ndërkombëtare, evropiane, të harmonizuara ose kombëtare.

•“Standard ndërkombëtar” nënkupton një standard të miratuar nga një organ ndërkombëtar standardizimi.

•“Standard evropian” nënkupton një standard të miratuar nga një organizatë standardizimi evropiane.

•“Standard i harmonizuar” nënkupton një standard evropian të miratuar në bazë të një kërkesë të bërë nga Komisioni Evropian për zbatimin e legjislationit të harmonizimit të Bashkimit Evropian.

•“Standard kombëtar” nënkupton një standard të miratuar nga një organ kombëtar standardizimi.

• Sistemi i standardizimit në BE përbëhet nga tre organe standarde mbikombëtare:

• Komiteti Evropian për Standardizim (CEN),

• Komiteti Evropian për Standardet në Elektroteknikë (CENELEC), dhe

• Instituti Evropian i Standardeve të Telekomunikacionit (ETSI)

• Për të kërkuar një standard Evropian mund të kërkojmë në portalet e organizatave evropiane të standardizimit:

- Katalogu nga CENELEC për standardet elektroteknike është i qasshëm në linkun”
<https://www.cenelec.eu/european-standardization/european-standards/>

- Katalogu nga ETSI për standardet e telekomunikacionit është i qasshëm në linkun:
<https://www.etsi.org/standards>

- Katalogu nga CEN për të gjitha standardet e tjera është i qasshëm në linkun:<https://standards.cenelec.eu/dyn/www/?p=CEN:105::RESET:::>

4.2 Vlerësimi i konformitetit

- Rregulloja (KE) Nr. 765/2008 për përcaktim të kërkesave për akreditim dhe mbikëqyrje të tregut në lidhje me marketingun e produkteve definon kërkesat për vlerësim të konformitetit.

- Vlerësimi i konformitetit - është proces i cili duhet të kryhet nga prodhuesi, për të demonstruar se kërkesat e specifikuara ndaj produktit përpara se të vendoset në treg janë përmbushur. Një produkt i nënshtrohet vlerësimit të konformitetit si gjatë fazës së projektimit, ashtu dhe gjatë procesit të prodhimit.

- Vlerësimi i konformitetit - përfshinë testimin, inspektimin dhe certifikimin e produktit, duke aplikuar këto varësisht prej natyrës së produktit dhe sektorit.

- Procesi i vlerësimit të konformitetit fillon me:

- Zgjedhjen e procedurave apo modulit të përcaktuar sipas vendimit nr. 786/2008;

- Përgatitjen e dokumentacionit teknik;

- Prodhuesi kryen vlerësimin e konformitetit pa përfshirjen e palëve të treta (kur nuk kërkohet nga moduli i përzgjedhur);

- Një palë e tretë kryen procedurat e vlerësimit të konformitetit (kur kërkohet nga moduli i përzgjedhur);

- Pas marrjes së vlerësimit “Pozitiv”, prodhuesi harton deklaratën e konformitetit dhe vendos shenjën CE.

- Kur legjislacioni në fuqi kërkon përfshirjen e një organi të vlerësimit të konformitetit, prodhuesi mund të gjej listën e Organeve të Notifikuara në faqen e internetit të NANDO në linkun: <https://ec.europa.eu/growth/tools-databases/nando/index.cfm?fuseaction=country.main>

Prodhuesit duhet të sigurohen që për prodhimin në seri, të sigurohet mbajtja në konformitetit. Ndryshimet në dizajnin ose karakteristikat e produktit dhe ndryshimet në standardet e harmonizuara ose në specifikimet teknike në bazë të të cilave deklarohet konformiteti i produktit duhet të merren parasysh në mënyrë adekuate.

4.2.3 Shënimi CE (The Conformité Européenne) në produkt

- Vendosja e markës CE në një produkt shërben si deklaratë nga prodhuesi se, produkti është projektuar dhe prodhuar sipas kërkesave dhe rregulloreve të BE-së lidhur me sigurinë, shëndetin, efikasitetin e energjisë ose shqetësimet mjedisore.

- Shenja CE është e detyrueshme dhe duhet të vendoset përpara se produkti të vendoset në tregun e Bashkimit Evropian.

- Shenja CE duhet të jetë e dukshme, e lexueshme dhe e pashlyeshme.

4.2.3.1 Si ta vendosim shenjën CE?

- Shenja CE duhet të vendoset në produkt. Nëse marka CE nuk mund të vendoset në vetë produktin, duhet të vendoset në paketim nëse ka, ose në ndonjë dokument shoqërues. Nëse produkti i nënshtrohet disa direktivave/rregulloreve të BE-së të cilat kërkojnë vendosjen e markës CE, dokumentet shoqëruese duhet të tregojnë se produkti është në përputhje me të gjitha direktivat/rregulloret e zbatueshme të BE-së

Shenja CE kërkohet për produktet dhe familjet e mëposhtme të produkteve:

- elektronikë
- pajisjet mjekësore
- lodrat
- pajisjet elektrike
- produktet ndërtimore- .

4.2.3.2 Procedura e vendosjes së shenjë CE

Është përgjegjësi e prodhuesit të kryej vlerësimin e konformitetit, të krijoj dosjen teknike, të lëshojë deklaratën e konformitetit të BE-së dhe të vendosë markimin CE në një produkt.

Për te vendosur një marke CE në produktin e tij, një prodhues duhet të ndjek këta hapa:

• **Hapi 1.** Të identifikoj direktivat e zbatueshme për produktin përkatës. Direktivat janë të qasshme në linkun: https://single-market-economy.ec.europa.eu/single-market/ce-marking/manufacturers_en.

• **Hapi 2.** Të identifikoj nëse ka ndonjë standard të harmonizuar Evropian të zbatueshëm për produktin e tij.

• **Hapi 3.** Të verifikoj kërkesat specifike sa i përket procedurës së vlerësimit të konformitetit. Procedura e vlerësimit të konformitetit do të ndryshojë në varësi të produktit dhe direktivës e cila rregullon markimin CE. Kjo procedurë mund të jetë: vetëdeklarim, të përfshijë testim, inspektim ose vlerësim të cilësisë së sistemit nga një Organ i Notifikuar ose një kombinim i tyre.

• **Hapi 3.** Të identifikoj nëse është i nevojshëm një vlerësim i pavarur i konformitetit bazuar në direktivën ose kërkesën e ndonjë Organi të Notifikuar. Një listë e Organeve të Notifikuara dhe direktivat përkatëse mund të gjenden në faqen e internetit të NANDO: <https://ec.europa.eu/growth/tools-databases/nando/>

• **Hapi 4.** Të testoj produktin dhe kontrolloj konformitetin e tij.

• **Hapi 5.** Të hartoj dhe mbaj në dispozicion dokumentacionin teknik të kërkuar. Deklarata e Konformitetit së bashku me Dokumentacionin Teknik duhet të jetë në dispozicion të Autoriteteve Kompetente (Shteteve anëtarë të BE-së) sipas kërkesës.

• **Hapi 6.** Të kontrolloj nëse ekzistojnë kërkesa të tjera kombëtare në vendet ku do të shitet produkti. Këto mund të përfshijnë standardet kombëtare, kërkesat e etiketimit ose paketimit.

• **Hapi 7.** Të vendos shenjën CE sipas kritereve të përcaktuara me Direktivë.

4.2.3.3 Kërkesat e vendosjes së markës CE

• Shenja CE duhet të jetë e dukshme, e lexueshme dhe e pashlyeshme.

• Shenja CE duhet të përbëhet nga inicialet “C” dhe “E”, të dyja shkronjat duhet të kenë të njëjtin dimension vertikal dhe të jenë jo më të vogla se 5 mm (përveç nëse specifikohet ndryshe në kërkesat përkatëse të produktit).



Fig. 1 Dimensionet dhe dizajni i shenjë CE

• Nëse marka CE nuk mund të vendoset në vetë produktin, mund të vendoset në paketim nëse ka, ose në ndonjë dokument shoqërues. Nëse produkti i nënshtrohet disa direktivave apo rregulloreve të BE-së të cilat kërkojnë vendosjen e një marke CE, dokumentet shoqëruese duhet të tregojnë se produkti është në përputhje me të gjitha direktivat/rregulloret e zbatueshme të BE-së.

4.2.4 Përgatitja e dokumentacionit teknik

• Prodhuesi duhet të hartojë dokumentacion teknik. Dokumentacioni teknik ka për qëllim të japë informacion mbi projektimin, prodhimin dhe funksionimin e produktit.

• Dokumentacioni teknik i kërkuar për vlerësimin e konformitetit në BE mund të ndryshojë në varësi të llojit të produktit dhe legjislacionit të zbatueshëm të BE-së. Sidoqoftë, në përgjithësi dokumentacioni teknik duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

• emrin dhe adresën e prodhuesit, ose ato të ndonjë përfaqësuesi të autorizuar;

• një përshkrim të shkurtër të produktit dhe të përdorimit të tij të synuar, si dhe të mbulojnë detajet e projektimit, prodhimit dhe funksionimit të produktit;

• analiza e rrezikut dhe një përshkrim i metodave të aplikuara për të eliminuar rreziqet e paraqitura nga produkti;

• listën e standardeve të harmonizuara ose specifikime të tjera teknike, të aplikuara në tërësi apo pjesërisht, si dhe përshkrimin e zgjidhjeve të aplikuara për të përmbushur kërkesat thelbësore të instrumentit legjislativ të aplikueshëm kur standardet e harmonizuara nuk janë aplikuar;

- rezultatet e testit: kalkulimet e bëra, ekzaminimet e ndërmarra etj.;
- identifikimi i produktit, për shembull, numri serial i produktit;
- emrin dhe adresën e çdo organi të notifikuar të përfshirë në vlerësimin e konformitetit të produktit;
- një deklaratë të procedurës së vlerësimit të konformitetit që është ndjekur;
- deklaratën e konformitetit të BE-së;
- një deklaratë e rregulloreve përkatëse me të cilat produkti është në përputhje.

4.2.5 Deklarata e konformitetit (DoC)

- Deklarata e konformitetit të BE-së (DoC) është një dokument i detyrueshëm që prodhuesit duhet ta nënshkruajnë për të deklaruar se produkti është në përputhje me kërkesat thelbësore të direktivave të BE-së në fuqi ose që produkti është në përputhje me llojin për të cilin është lëshuar certifikata e ekzaminimit të tipit dhe plotëson kërkesat thelbësore të direktivave në fuqi.
- Me nënshkrimin e DoC-së prodhuesi merr përgjegjësinë e plotë për pajtueshmërinë e produktit me ligjet në fuqi të BE-së.
- Deklarata e konformitetit të BE-së duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm për të identifikuar legjislacionin e harmonizimit të Bashkimit sipas të cilit kjo deklaratë është lëshuar, si dhe prodhuesin, përfaqësuesin e autorizuar, organin notifikues nëse është e aplikueshme, dhe aty ku është e përshtatshme një referencë ndaj standardeve të harmonizuara ose specifikimeve të tjera teknike sipas të cilave është prodhuar produkti. Kërkesat specifike të DoC janë përcaktuar në Annex III në vendimin Nr. 768/2008/KE.

Prodhuesit duhet të kenë parasysh se:

ekzistojnë gjithashtu rregulla të produkteve që nuk janë të harmonizuara në BE, kjo do të thotë se specifikimet mund të ndryshojnë në çdo shtet anëtar të BE-së. Në raste të tilla, ju duhet të respektoni vetëm rregullat e zbatueshme në shtetin anëtar të BE-së ku keni ndërmend të vendosni produktin tuaj në treg.

Detajet e autoriteteve kompetente për kërkesat kombëtare të produkteve mund t'i gjeni në linkun:

https://single-market-economy.ec.europa.eu/single-market/goods/free-movement-sectors/mutual-recognition-goods/product-contact-points_en

4.3 Gjurmueshmëria

- Rregullorja (KE) Nr. 765/2008, gjithashtu, përcakton praktikat aktuale në lidhje me gjurmueshmërinë duke kërkuar vendosjen e etiketave specifike. Etiketimi i gjurmueshmërisë së produkteve është i detyrueshëm për një gamë të gjerë produktesh, të tilla si elektronike, produkte kuzhine, lodra dhe shumë produkte të tjera.

4.3.1 Çfarë është gjurmueshmëria e produktit?

- Gjurmueshmëria, në kontekstin e industrisë së produkteve të konsumit, nënkupton aftësinë për të gjurmuar origjinën e një produkti. Kjo procedurë, mundëson gjurmimin e një produkti dhe të kompanisë që mbahet përgjegjëse për sigurinë e produktit kur ndodhin incidente, kur produkti konsiderohet me defekt ose kur konsiderohet i pasigurt për t'u konsumuar apo nuk është në pajtim me kërkesat e BE-së për produktet.

4.3.2 Cilat janë kërkesat për bizneset?

- Dispozitat referuese të Vendimit Nr. 768/2008/KE të pasqyruara në legjislacionin e harmonizimit të Bashkimit kërkojnë që prodhuesit apo importuesit:
- Të tregojnë tri elemente si në vijim: (1) emrin e tyre, (2) emrin tregtar të regjistruar ose markën e regjistruar tregtare dhe (3) adresën në të cilën mund të kontaktohen. Këto duhet të vendosen në produkt ose, kur nuk është e mundur, në paketimin e tij ose në një dokument që shoqëron produktin. Adresa duhet të tregojë një pikë të vetme në të cilën mund të kontaktohet prodhuesi.
- Prodhuesi duhet të sigurohet se produkti i tij mbanë llojin, batch ID apo numrin serik dhe datën e prodhimit. Këto duhet të vendosen në produkt, por kur madhësia ose natyra e produktit nuk e mundëson, atëherë informacioni i kërkuar duhet të jepet në paketim ose në një dokument që shoqëron produktin.
- Prodhuesit duhet të sigurojnë që produkti të shoqërohet me udhëzime dhe informacion sigurie në një gjuhë që mund të kuptohet lehtësisht nga konsumatorët dhe përdoruesit e tjerë fundor, siç përcaktohet nga Shteti Anëtar në fjalë.

4.3.3 Kërkesat e etiketimit/shënjit

- Prodhuesit, importuesit në BE apo edhe personat e autorizuar të cilët veprojnë në BE duhet të sigurohen rreth kërkesave specifike në lidhje me shenjat dhe etiketat.
- Shenja – është një simbol dhe/ose piktogram që shfaqet në një produkt ose në paketimin e tij. Qëllimi i këtyre shenjave është t'u sigurojë palëve të interesit informacion në lidhje me sigurinë, shëndetin, efikasitetin e energjisë dhe çështjet mjedisore në lidhje me produktin.

•Etiketat – janë në formën e tekstit të shkruar ose deklaratave numerike. Etiketat zakonisht tregojnë informacion më specifik rreth një produkti, si p.sh. njësinë matëse ose materialet që mund të gjenden në produkt (të tilla si tekstile ose bateri). Furnizuesi duhet të sigurojë që produktet që vendosen në treg të shoqërohen, për çdo njësi individuale, me etiketa të sakta të printuara dhe me fletë informacion të produktit në përputhje me rregulloret përkatëse.

•Legjislacioni Evropian parasheh një liste të produkteve të cilat kërkojnë shpalosjen e detajeve në etiketa në mënyrë që klienti të bëjë blerje të mirinformuar.

•Disa etiketa janë të detyrueshme dhe disa janë vullnetare.

Furnizuesit në BE duhet t'i kushtojnë rëndësi sidomos etiketimit të këtyre produkteve për të cilat etiketimi është i obliguar:

- produkteve energjetike
- mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike (WEEE)
- etiketat e këpucëve
- tekstili

•Direktiva 2012/19/BE përcakton se simboli që tregon grumbullimin e veçantë për pajisjet elektrike dhe elektronike (EEE) përbëhet nga koshi i kryqëzuar me rrota, siç tregohet më poshtë. Simboli duhet të printohet në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të pashlyeshme.



Fig. 21 Logo për WEEE

• Rregullorja (BE) Nr. 1007/2011 përcakton se etiketat e tekstitil janë të detyrueshme në BE për tekstilet e destinuara për shitje tek konsumatori përfundimtar. Etiketa e tekstitil duhet të:

- Shpjegoj përbërjen e pëlhurës;
- Tregoj fontin, madhësinë dhe stilin;
- Përmbaj një ndarje të qartë midis informacionit mbi përbërjen e tekstitil dhe informacioneve të tjera, siç është kujdesi për produktin;
- Përdor tekst të qartë dhe të lexueshëm, duke përfshirë shkronja uniforme.

• Udhëzimi mbi mënyrën e përcaktimit të materialit është i qasshëm në linkun: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX:32011R1007#d1e32-12-1>

4.3.4 Kërkesat sa i përket gjuhës së përdorur në etiketa

• .Nëse planifikoni t'i shisni produktet në një ose më shumë vende të BE-së, duhet ta përktheni tekstin në të gjitha gjuhët zyrtare kombëtare ku produktet janë të disponueshme për konsumatorin.

4.3.5 Ekolabeli i BE-së

• Furnizuesit në BE mund të përdorin disa etiketa vullnetare të cilat kryesisht kanë ndikim tek konsumatorët në përzgjedhjen e produktit përkatës. Një prej këtyre etiketave gjerësisht të përdorura është EU Ekolabel.



Pic. 3. Label "EU Ecolabel"

4.3.5.1 Si ta vendosim këtë shenjë në etiketë?

• Bizneset duhet të aplikojnë për të marrë të drejtën e vendosjes së kësaj shenje në etikete. Kjo shenjë mund të vendoset në produktet të cilat plotësojnë kriteret strikte ekologjike, duke ndjekur hapat si në vijim:

1 Aplikoni për të fituar të drejtën e vendosjes së shenjës “EU Ecolabel”. Për produktet kosovare, të cilat e kanë origjinën jashtë ZEE-së, aplikacioni duhet t’i paraqitet një organi kompetent në cilindo nga Shtetet Anëtare në të cilin produkti do të vendoset në treg. Linku për të kontaktuar organet kompetente: https://environment.ec.europa.eu/topics/circular-economy/eu-ecolabel-home/community-and-helpdesk_en

2 Regjistroni produktin apo shërbimin në katalogun online (ECAT), i cili është i qasshëm në linkun: <https://ec.europa.eu/ecat/>

3 Krijoni dosjen e aplikacionit me përshkrimin dhe testimin e produktit apo shërbimit. Dosja e aplikimit kërkohet nga të gjithë aplikantët në mënyrë që të vlerësohet pajtueshmëria me kriteret. Organi Kompetent ku ju aplikoni do të verifikojë që të gjitha informacionet janë paraqitur dhe do t’ju kërkojë dokumentacion të mëtijshëm nëse është e nevojshme.

4 Dorëzoni aplikacionin dhe paguani tarifat. Vlera e tarifës do të ndryshoj varësisht nga madhësia e kompanisë. Listën e fundit të tarifave mund ta gjeni në linkun: https://environment.ec.europa.eu/system/files/2023-02/EU_Ecolabel_fees_table_2023_02.pdf

5 Organi kompetent do të vlerësoj aplikacionin dhe të kthej përgjigje brenda afatit të caktuar.

6 Nëse kërkesa aprovohet Organi kompetent do të lëshojë kontratën dhe licencën.

7 Vendoseni EU Ecolabel në produktin tuaj. Linku ku mund të gjeni udhëzimet e vendosjes së logos në produkt është i qasshëm në: https://environment.ec.europa.eu/topics/circular-economy/eu-ecolabel-home/eu-ecolabel-branding_en

4.4. Rregullat e origjinës së produktit

• Rregullat e origjinës përcaktojnë se në cilin vend produkti është marrë ose prodhuar dhe ndihmojnë për të siguruar nëse produkti mund të importohet në BE apo jo, si dhe ndihmojnë autoritetet të zbatojnë saktë tarifat doganore. Këto produkte mund të eksportohen në BE si produkte preferenciale apo me origjinë jo preferenciale. Për t’u kualifikuar për trajtim preferencial, produkti duhet të plotësojë rregullat e origjinës sipas marrëveshjeve ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

• Kosova si shtet joevropian, sa i përket origjinës së produkteve, përfiton nga dy marrëveshje me BE-në:

• Konventa Pan-Euro-Mesdhetare (PEM)

• Marrëveshjet e Stabilizim Asociimit (MSA)

Vegla e vetëvlerësimit të rregullave të origjinës (ROSA– the Rules of Origin Self-Assessment) ju ndihmon të vlerësoni përputhshmërinë e produktit dhe marrëveshjes.

Kjo vegël është e qasshme në linkun: <https://trade.ec.europa.eu/access-to-markets/en/home>

5. Shitja e produkteve dhe shërbimeve në BE

• Për të shitur produktet në tregun e BE-së, shitësit duhet të sigurohen që produktet plotësojnë kërkesat e BE-së për mbrojtjen dhe shëndetin e njerëzve dhe kafshëve, si dhe mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve.

5.1. Pajtueshmëria me standardet mjedisore

• BE-ja ka disa nga standardet më të larta mjedisore në botë, të zhvilluara gjatë dekadave.

• Politika mjedisore ndihmon ekonominë e BE-së të bëhet më miqësore me mjedisin, mbron burimet natyrore të Evropës dhe mbron shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve që jetojnë në BE.

• Cilësia e mjedisit është thelbësore për shëndetin, ekonominë dhe mirëqenien tonë.

• Megjithatë, ajo përballlet me disa sfida serioze, jo vetëm ato të ndryshimeve klimatike, konsumit dhe prodhimit të paqëndrueshëm, por edhe me forma të ndryshme të ndotjes.

• Politikat mjedisore dhe legjislacioni i BE-së mbrojnë habitatet natyrore, mbajnë ajrin dhe ujin, sigurojnë asgjësimin e duhur të mbetjeve, përmirësojnë njohuritë rreth kimikateve toksike dhe ndihmojnë bizneset të ecin drejt një ekonomie të qëndrueshme.

• Neni 191 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) përcakton se politikat e BE-së për mjedisin i kontribuojnë objektivave si:

• ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit,

• mbrojtjen e shëndetit të njeriut,

• shfrytëzimin e kujdesshëm dhe racional të burimeve natyrore,

• promovimin e masave në nivel ndërkombëtar për t’u marrë me mjedisin rajonal ose mbarë botëror,

• problemet, dhe në veçanti luftimin e ndryshimeve klimatike.

5.2. Rregullat e konkurrencës në Bashkimin Evropian

• Konkurrenca e lirë është një element kyç i një ekonomie apo tregu të hapur.

- Legjislacioni i Bashkimit Evropian për konkurrencën përbëhet nga dispozitat përkatëse të Traktatit të Bashkimit Evropian (TBE), Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) dhe disa rregullore, si:

- Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1/2003 e 16 dhjetorit 2002 për zbatimin e rregullave për konkurrencën, të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit;

- Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 139/2004 e 20 janarit 2004 për kontrollin e përqendrimeve mes ndërmarrjeve (Rregullorja e Bashkimit e KE-së);

- Rregullorja e Komisionit (BE) nr. 330/2010 e 20 prillit 2010 për zbatimin e nenit 101 (3) të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian në kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara;

- Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 802/2004 e 7 prillit 2004 që zbaton Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 139/2004 e 20 janarit 2004 për kontrollin e përqendrimeve mes ndërmarrjeve.

5.3 TBE dhe TFBE – dispozitat relevante për konkurrencën

- Me Traktatin e Bashkimit Evropian (TBE) (në nenin 3, par. 3) Bashkimi Evropian ka krijuar një treg të brendshëm.

- Gjithashtu, BE angazhohet për zhvillimin e qëndrueshëm të Evropës bazuar në rritjen e balancuar ekonomike dhe stabilitetin e çmimeve, një ekonomi të tregut sociale dhe shumë konkurruese, duke synuar punësimin e plotë dhe përparimin social dhe një nivel të lartë mbrojtjeje dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit.

- Me Traktatin për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) (në nenin 3, par. 1) “vendosja e rregullave të konkurrencës të nevojshme për funksionimin e tregut të brendshëm” është në kompetencën ekskluzive të Bashkimit Evropian.

5.4 TFBE – dispozitat relevante për konkurrencën:

- Me nenet 101 deri 109 të Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian (TBE) janë përcaktuar rregullat e përgjithshme për konkurrencën në Bashkimin Evropian.

- Rregullat e BE-së për konkurrencën janë krijuar për të siguruar kushte të drejta dhe të barabarta për bizneset, duke lënë hapësirë për inovacion, standarde të unifikuara dhe zhvillim të bizneseve të vogla.

- Komisioni Evropian monitoron dhe heton praktikën kundër konkurrencës, shkrirjet dhe ndihmën shtetërore për të siguruar një fushë loje të barabartë për bizneset e BE-së, duke garantuar zgjedhje dhe çmime të drejta për konsumatorët.

5.5 Neni 101 i TFBE-së – marrëveshjet e paligjshme

- Ndalohen si të papajtueshme me tregun e brendshëm:

- Të gjitha marrëveshjet ndërmjet ndërmarrjeve,

- Vendimet e shoqatave të ndërmarrjeve dhe praktikave të bashkërenduara të cilat mund ndikojnë në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare dhe që kanë si objekt ose efekt parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës brenda tregut të brendshëm, dhe në veçanti ato që:

- përcaktojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi çmimet e blerjes ose të shitjes ose çdo kusht tjetër tregtimi;

- kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimin;

- ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;

- zbatojnë kushte të ndryshme për transaksionet ekuivalente me palët e tjera tregtare, duke vendosur kështu ata në një disavantazh konkurrues;

- kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera të detyrimeve shtesë të cilat, për nga natyra e tyre ose sipas përdorimit tregtar, nuk kanë asnjë lidhje me objektin e kontratave të tilla.

- Çdo marrëveshje ose vendim i ndaluar në bazë të neni 101 të TFBE-së është automatikisht i pavlefshëm.

- Megjithatë, ndalesat e tilla mund të shpallen të pazbatueshme në rastin e:

- çdo marrëveshje ose kategori marrëveshjesh ndërmjet ndërmarrjeve,

- çdo vendim ose kategori vendimesh nga shoqatat e ndërmarrjeve,

- çdo praktike të bashkërenduar ose kategorie praktikash të bashkërenduara.

Marrëveshja që kontribuon në përmirësimin e prodhimit ose shpërndarjes së mallrave, ose në promovimin teknik ose në progresin ekonomik, ndërkohë që u lejon konsumatorëve një pjesë të drejtë të përfitimit që rezulton, si dhe që nuk:

- vendosë mbi ndërmarrjet përkatëse kufizime që nuk janë të domosdoshme për arritjen e këtyre objektivave;

- t’u japë ndërmarrjeve të tilla mundësinë për të eliminuar konkurrencën në lidhje me një pjesë të konsiderueshme të produkteve në fjalë.

5.6 Neni 102 i TFBE-së – keqpërdorimi i pozitës dominuese në tregun e BE-së

• Çdo keqpërdorim nga një ose më shumë ndërmarrje i një pozicioni dominues në tregun e brendshëm ose në një pjesë të konsiderueshme të tij, ndalohej si e papajtueshme me tregun e brendshëm për atë sa mundet të ndikojë në tregtinë ndërmjet shteteve anëtare.

• Një keqpërdorim i tillë, në veçanti, mund të konsistojë në:

• Imponimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes ose kushteve të tjera të padrejta tregtare;

• Kufizimin e prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik në dëm të konsumatorëve;

• Aplikimin e kushteve të ndryshme për transaksionet ekuivalente me palët e tjera tregtare, për rrjedhojë vendosjen e tyre në disavantazh konkurrues;

• Kushtëzimin e lidhjes së kontratave me pranimin nga palët e tjera të detyrimeve shtesë, të cilat për nga natyra e tyre ose sipas përdorimit tregtar, nuk kanë asnjë lidhje me objektin e kontratave të tilla.

5.7 Aplikimi i procedurës sipas nenit 101 dhe 102 të TFBE-së

5.7.1 Faza hetimore

• Rastet e sjelljeve të supozuara kundër konkurrencës mund:

• Të jenë të bazuara në ankesat nga kompanitë, personat fizikë dhe juridikë ose qeveritë e BE-së;

• Të jenë të hapura nga vetë Komisioni, i cili gjithashtu inkurajon kompanitë dhe publikun që ta informojë atë për keqbërje të dyshuara.

• Në një vlerësim fillestar, Komisioni:

• Cakton rastin brenda Rrjetit Evropian të Konkurrencës;

• Shqyrton nëse një rast meriton hetime të mëtejshme;

• Hedh poshtë disa raste për shkak të arsyeve të pamjaftueshme për të vepruar;

• Fokusohet në rastet me ndikim të rëndësishëm në tregun e brendshëm dhe me rrezik për të dëmtuar konsumatorët;

• Informon adresuesit e masave hetimore për objektin dhe qëllimin e tyre;

• Paralajmëron ankuesit për veprimin që propozon të ndërmarrë.

Duke hapur zyrtarisht procedurat, Komisioni:

• Sinjalizon se do të hetojë më tej rastin;

• Identifikon dhe informon palët e përfshira dhe përshkruan fushëveprimin e hetimit;

• Thekson se procedura nuk paragjykon ekzistimin e shkeljes.

• Komisioni mund:

• Të kërkojë nga kompanitë që t'i japin të gjithë informacionin e nevojshëm brenda afateve të caktuara kohore;

• Të mbajë takime me palët e interesuara, ankuesit apo të tjerë;

• Të marrë deklaratat nga persona fizikë ose juridikë me të dhëna të dobishme;

• Të inspektojë ambientet e një kompanie dhe vende të tjera;

• Të ndajë informacionin me autoritetet kombëtare të konkurrencës;

• Të organizojë takime informuese vullnetare me kompanitë nën hetim në fazat kyçe të çështjes;

• Të lejojë palët të shqyrtojnë parashtrësit kryesore si një version jo konfidencial i ankësës në një fazë të hershme.

• Rezultatet e mundshme të fazës hetimore janë:

• Miratimi i një deklarate kundërshtimesh me qëllim të një vendimi ndalimi për të gjitha ose disa nga çështjet e identifikuara;

• Diskutimi i një vendimi të mundshëm angazhimi me kompanitë e përfshira, nëse dëshirojnë, për të adresuar çështjet e konkurrencës në fjalë;

• Mbyllja e procedurës nëse nuk ka arsye për të vazhduar.

• Pas hetimit të tij të thelluar, Komisioni miraton për të garantuar të drejtën e kompanisë për të dëgjuar një deklaratë kundërshtimesh. Ky vlerësim paraprak i shkeljeve të supozuara:

• Informon kompanitë për akuzat me të cilat përballen, duke u dhënë atyre mundësi të përgjigjen;

• Përcakton mjetet juridike që Komisioni planifikon të vendosë për t'i dhënë fund sjelljes antikonkurrese;

• Tregon nëse Komisioni planifikon të vendosë gjopa për kompanitë, si mund të llogariten ato dhe nëse ato mund të reduktohen;

• U lejon adresuesve të qasen në dosjen e çështjes së Komisionit dhe, nëse është e nevojshme, disa informacione konfidenciale;

• U siguron kompanive të drejtën e një përgjigjeje me shkrim;

• Shoqëron ankuesit me procedurat duke u dhënë atyre një version jo konfidencial të deklaratës së kundërshtimeve;

• U jep palëve të interesuara të drejtën për një seancë dëgjimore për të zhvilluar argumentet e tyre me shkrim, për të plotësuar provat e tyre me shkrim ose për të informuar Komisionin për çështje të tjera relevante;

• Pasohet nga një deklaratë plotësuese e kundërshtimeve nëse dalin prova të reja përkatëse ose nëse kompanitë të cilat mund t'i përgjigjen zhvillimeve të reja, përballen me ndëshkime më të rënda.

• Në fund të procesit, Komisioni mund:

• Të vendosë se ka pasur shkelje të rregullave përkatëse të konkurrencës;

• Të tërheqë disa nga kundërshtimet e saj duke vazhduar me të tjerat;

• Të mbyllë rastin.

• Komisioni u siguron kompanive të përfshira menjëherë vendimin pasi të jetë marrë, lëshon një deklaratë për shtyp dhe publikon një version jokonfidencial në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Konkurrencës

5.8 Neni 107 i TFBE-së – ndihma shtetërore:

• Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në traktatet, çdo ndihmë e dhënë nga një shtet anëtar ose nëpërmjet burimeve shtetërore në çfarëdo forme, që shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke favorizuar ndërmarrje të caktuara ose prodhimin e mallrave të caktuara, për aq sa ndikon në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare, është e papajtueshme me tregun e brendshëm.

• Rastet e më poshtme janë në përputhje me tregun e brendshëm:

• Ndihma me karakter social, e dhënë për konsumatorët individual, me kusht që kjo ndihmë të jepet pa diskriminim në lidhje me origjinën e produkteve në fjalë;

• Ndihma për të korrigjuar dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose ndodhitë e jashtëzakonshme;

• Ndihma e dhënë për ekonominë e zonave të caktuara të Republikës Federale të Gjermanisë të prekura nga ndarja e Gjermanisë, për aq sa kërkohet një ndihmë e tillë për të kompensuar disavantazhet ekonomike të shkaktuara nga kjo ndarje. Pesë vjet pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, Këshilli, duke vepruar me propozim të Komisionit, mund të miratojë një vendim që e shfuqizon këtë pikë.

• Rastet e mëposhtme mund të konsiderohen të pajtueshme me tregun e brendshëm:

• Ndihma për të nxitur zhvillimin ekonomik të zonave ku standardi i jetesës është jo normalisht i ulët ose ku ka nën punësim serioz, dhe të rajoneve të përmendura në nenin 349, në kuptim të gjendjes së tyre strukturore, ekonomike dhe sociale;

• Ndihma për të nxitur ekzekutimin e një projekti të rëndësishëm me interes të përbashkët evropian ose për adresuar një shqetësim serioz në ekonominë e një shteti anëtar;

• Ndihma për të lehtësuar zhvillimin e aktiviteteve të caktuara ekonomike ose të zonave të caktuara ekonomike, kur një ndihmë e tillë nuk ndikon negativisht në kushtet e tregtimit në një masë të kundërt me interesin e përbashkët;

• Ndihma për të promovuar kulturën dhe ruajtjen e trashëgimisë kur një ndihmë e tillë nuk ndikon në kushtet e tregtisë dhe konkurrencës në Bashkim në një masë që është në kundërshtim me interesin e përbashkët;

• Kategoritë e tjera të ndihmës që mund të specifikohen me vendim të këshillit me një propozim nga komisioni.

5.9 Shërbimet e interesit të përgjithshëm ekonomik (SHIPE)

• Shërbimet me interes të përgjithshëm ekonomik janë aktivitete ekonomike, të tilla si rrjetet e transportit dhe shërbimet postare dhe sociale, të konsideruara nga autoritetet publike si veçanërisht të rëndësishme për qytetarët dhe që nuk do të ofroheshin (ose do të ofroheshin në kushte të ndryshme) nëse nuk do të kishte ndërhyrje publike.

Kompensimi për SHIPE:

• Sipas vendimit Altmark të vitit 2003 të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJEDU), kompensimi i shërbimit publik nuk përbën ndihmë shtetërore kur plotësohen 4 kushtet kumulative:

1 Ofruesi i shërbimit përfitues duhet të ketë **detyrime të përcaktuara qartë të shërbimit publik;**

2 Metoda për llogaritjen e kompensimit duhet të jetë **objektive, transparente dhe e përcaktuar paraprakisht;**

3 Kompensimi nuk mund të tejkalojë **kostot përkatëse dhe një fitim të arsyeshëm, domethënë asnjë mbi kompensim; dhe**

4 Ofruesi zgjidhet nëpërmjet një procedure prokurimi publik, ose niveli i kompensimit llogaritet bazuar në një analizë të kostove të një **biznesi mesatar ‘të mirëdrejtuar’** në sektorin në fjalë.

• Kur një ose më shumë nga këto kushte nuk plotësohen, kompensimi i shërbimit publik do të shqyrtohet sipas rregullave të ndihmës shtetërore.

5.10.1 Kualifikimet profesionale

• Një sistem i përgjithshëm i njohjes së kualifikimeve për të punuar në shumicën e profesioneve të rregulluara është vendosur në të gjithë BE-në. Nëse dëshironi të punoni në një profesion (për shembull si mësues, avokat, inxhinier ose psikolog) duhet të aplikoni për njohjen e kualifikimeve tuaja në atë vend.

• Nëse jeni mjek, infermiere e përgjithshme, dentist, mami, veteriner, farmacist ose arkitekt, kualifikimet tuaja kombëtare në parim njihen automatikisht.

• Ju mund të merrni ndihmë për kualifikimet profesionale në të gjithë BE-në nga portali evropian i punës, i cili është i qasshëm në linkun 5.11 Access to EU finances

5.11 Qasja në financat e BE-së

• Financimi i BE-së është i mundshëm për të gjitha llojet e kompanive të çdo madhësie dhe sektori, duke përfshirë sipërmarrësit, bizneset e reja, ndërmarrjet mikro, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe bizneset më të mëdha.

• Ekziston një gamë e gjerë financimi: kredi biznesi, mikrofinanca, garanci, investime kapitale për sipërmarrësit, zhvillimin e politikave të qëndrueshme ekonomike, zhvillimin e burimeve njerëzore si dhe investime në fushën e edukimit.

• Bashkimi Evropian sa i përket vendeve joevropiane, e më specifikisht Ballkanit Perëndimor, ka zhvilluar disa programe dhe iniciativa, që kontribuojnë në rritjen mirëqenies ku synon të rrisë ndërgjegjësimin, njohuritë dhe të kuptuarit e marrëdhënieve, në mes të vendeve të BE-së, Ballkanit Perëndimor dhe politikës së zgjerimit të BE-së.

• Disa nga nismat kryesore të BE-së dhe programet e financimit në Ballkanin Perëndimor mund t'i gjeni në linkun: <https://webalkans.eu/en/about/>

6 Ndërveprimi me klientët e BE-së

6.1 Mbrojtja e konsumatorëve në Bashkimin Evropian

- Traktati për Funksonimin e Bashkimit Evropian (TFBE) në nenin 12 përcakton se:

“Kërkesat për mbrojtjen e konsumatorit do të merren parasysh në përcaktimin dhe zbatimin e politikave dhe aktiviteteve të tjera të Bashkimit”.

- Ndërsa, në nenin 169 të TFBE-së, përcaktohet se:

“Për të promovuar interesat e konsumatorëve dhe për të siguruar një nivel më të lartë të mbrojtjes së konsumatorit, Bashkimi do të kontribuojë në mbrojtjen e shëndetit, interesave ekonomike dhe të sigurisë së konsumatorit, si dhe për të promovuar të drejtën e tyre për informim, edukim dhe për t’u organizuar me qëllim të mbrojtjes së interesave të tyre.”

- Direktiva 2011/83/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 25 tetorit 2011 mbi të drejtat e konsumatorëve, e përkufizon termin “konsumator” dhe “tregtar”.

- Termi “konsumator” nënkupton “çdo person fizik i cili në kontratat e mbuluara nga kjo direktivë, vepron për qëllime të cilat janë jashtë tregtisë, biznesit, zanatit ose profesionit të tij”.

- Ndërsa, termi “tregtar” nënkupton “çdo person fizik ose çdo person juridik, pavarësisht nëse është në pronësi private apo publike, i cili ose vepron në emër të tij ose nëpërmjet çdo personi tjetër, për qëllime që lidhen me tregtinë e tij, biznesin, zanatin ose profesionin në lidhje me kontratat e mbuluara nga kjo direktivë”.

- Direktiva 2011/83/BE zbatohet për kontratat e lidhura pas datës 13 qershor 2014 (direktiva është e qasshme në linkun : <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32011L0083&from=EN>)

- Ndryshimi i Direktivës (BE) 2019/2161 zbatohet nga 28 maji 2022. **Kjo direktivë u jep konsumatorëve të njëjtat të drejta në të gjithë BE-në.**

- Ajo përafron dhe harmonizon rregullat kombëtare të konsumatorit, për shembull mbi informacionin që duhet t’u jepet konsumatorëve përpara se të blejnë mallra, shërbime ose përmbajtje digjitale, dhe mbi të drejtën e tyre për të anuluar blerjet online, kudo që ata blejnë në BE.

- Direktiva ndryshuese (BE) 2019/2161, zgjeron fushën e Direktivës 2011/83/BE për të mbuluar kontratat sipas të cilave tregtari furnizon ose merr përsipër të ofrojë shërbim digjital ose përmbajtje digjitale për konsumatorin, dhe konsumatori ofron ose merr përsipër të ofrojë të dhëna personale.

6.2 Detyrimet e informimit

- Përpara lidhjes së një kontrate, tregtarët duhet t’u ofrojnë konsumatorëve, në gjuhë të qartë dhe të kuptueshme, informacione të tilla si:

- Identitetin e tyre dhe detajet e kontaktit;

- Karakteristikat kryesore të produktit; dhe

- Kushtet që zbatohen, duke përfshirë kushtet e pagesës, kohën e dorëzimit, performancën dhe kohëzgjatjen e kontratës dhe kushtet e përfundimit.

- Në dyqane, duhet të jepen informacione shtesë që nuk janë të dukshme.

- Kërkesat e informacionit, veçanërisht për të drejtën e tërheqjes, janë më të detajuara për kontratat e lidhura në distancë (si në internet, me porosi telefonike ose me postë) dhe për kontratat e lidhura jashtë lokaleve (p.sh. kur një tregtar viziton shtëpinë e një konsumatori).

- Ndryshimi i Direktivës (BE) 2019/2161 i shton direktivës kërkesa specifike informacioni për kontratat e lidhura në tregjet online. Tregjet online duhet:

- Të informojnë konsumatorët nëse një furnizues i palës së tretë është tregtar ose jo-tregtar (d.m.th. një konsumator tjetër);

- Të paralajmërojnë konsumatorin se rregullat e BE-së për mbrojtjen e konsumatorit nuk zbatohen për kontratat e lidhura me jo-tregtarë; dhe

- Të japin shpjegime se kush është përgjegjës për ekzekutimin e kontratës: tregtari i palës së tretë ose vetë tregu online.

6.3 E drejta e tërheqjes

- Konsumatorët mund të tërhiqen nga kontratat në distancë dhe jashtë lokaleve brenda 14 ditëve nga dorëzimi i mallrave ose nga përfundimi i kontratës së shërbimit, me përjashtime të caktuara, pa asnjë shpjegim apo kosto. Mjafton një formular standard i tërheqjes i ofruar nga shitësi.

- Nëse konsumatorët nuk janë të informuar për të drejtat e tyre, periudha e tërheqjes zgjatet me 12 muaj.

- Përjashtimet zbatohen në disa rrethana, për shembull për mallrat që prishen, mallrat e mbyllura të hapura nga konsumatori që nuk mund të kthehen për arsye shëndetësore ose higjienike, dhe rezervime hotelesh ose makina me qira që lidhen me data specifike.

- Kur konsumatorët tërhiqen nga një kontratë, ata duhet të përmbahen nga përdorimi i përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital dhe nga vënia në dispozicion e palëve të treta.

6.4 Ndalohen pagesat e pajustificuara ose tarifat shtesë

- Tregtarët nuk duhet t'i ngarkojnë konsumatorët me tarifa për përdorimin e një mjeti pagese që janë më të larta se kostoja që përballon tregtari për përdorimin e këtyre mjeteve. Në shumë raste, ngarkimi i tarifave të tilla është plotësisht i ndaluar në përputhje me direktivën e shërbimeve të pagesave (Direktiva (BE) 2015/2366).
- Kur telefonon një tregtar për të pyetur ose ankuar për kontratën e lidhur, konsumatori nuk duhet të paguajë më shumë se tarifa bazë e telefonit.
- Tregtarët duhet të kenë pëlqimin e shprehur të një konsumatori kur ofrojnë shërbime shtesë me pagesë. Kutitë e shënjuara paraprakisht në një formular porositje nuk mund të përdoren për pagesa të tilla.

6.5 Sanksionet

- Direktiva 2011/83/BE kërkon që shtetet anëtare të vendosin gjoba efektive, dhe proporcionale që zbatohen për shkeljet e rregullave kombëtare që transpozojnë direktivën.
- Ndryshimi i Direktivës (BE) 2019/2161 prezanton një listë të kriterëve që duhet të zbatohen gjatë vendosjes së gjobave. Ajo gjithashtu kërkon që shtetet anëtare të parashikojnë mundësinë e vendosjes së gjobave deri në të paktën 4% të xhiros vjetore të tregtarit, ose 2 milion € kur informacioni për qarkullimin e tregtarit nuk është i disponueshëm.
- Gjoba të tilla duhet të jenë të disponueshme kur autoritetet e Shteteve Anëtare veprojnë së bashku për shkelje të mëdha ndërkufitare që prekin konsumatorët në disa shtete anëtare në kontekstin e rregullores së rrjetit të bashkëpunimit për mbrojtjen e konsumatorëve (Rregullorja (BE) 2017/2394).

6.6 Mbrojtja e të dhënave

- Në kuadër të Bashkimit Evropian mbrojtja e të dhënave personale përcaktohet nga Rregullorja (BE) 2016/679 (GDPR)

6.7 Kush duhet ta zbatojë këtë rregullore?

- Çdo kompani që ruan dhe proceson informata personale të qytetarëve të BE-së që:
- janë prezent në shtetet e BE-së;
- nuk janë prezent në BE por procesojnë të dhëna personale të qytetarëve të BE-së;
- kanë më shumë se 250 punëtorë;
- kanë më pak se 250 punëtorë, por përpunimi që kryhet ka të ngjarë të rezultojë në rrezik për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave.

Çfarë të dhënash mbrohen me këtë rregullore?

- E dhënë personale është çfarëdo e dhëne që mund të përdoret për të identifikuar një individ. Këto të dhëna mund të jenë:
- Të dhëna bazike të identitetit: emri, adresa, numri personal apo edhe e-mail adresa;
- Të dhënat nga, webfaqet lokacioni, IP adresa, të dhënat nga cookie, postimet në media sociale etj.;
- Të dhëna shëndetësore dhe gjenetike;
- Të dhënat biometrike;
- Të dhënat racore ose etnike;
- Opinionet politike;
- Orientimi seksual.
- Bizneset kosovare duhet të jenë veçanërisht të vëmendshme ndër të tjera, ndaj këtyre të drejtave të garantuara, me këtë rregullore të klientëve që vijnë nga BE:
- E drejta për tu informuar (neni 13);
- E drejta për qasje (neni 15);
- E drejta për korrigjim (neni 16);
- E drejta për t'u fshirë ('e drejta për t'u harruar') (neni 17);
- E drejta e kufizimit të përpunimit (neni 18).

6.9 Cilat janë përgjegjësitë e kontrollorit dhe përpunuesit të të dhënave?

- Bizneset kosovare duhet të kenë parasysh se:
- Neni 27- Përfaqësuesit e kontrollorëve ose përpunuesit e vendosur jashtë Bashkimit Evropian thekson se: "Kur zbatohet neni 3(2), kontrolluesi ose përpunuesi cakton me shkrim një përfaqësues në Bashkim.
- Detyrimi i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni nuk zbatohet për rastet kur:
- përpunimi që është i rastësishëm, nuk përfshin në një shkallë të gjerë, përpunimin e kategorive të veçanta të të dhënave siç referohet në nenin 9(1), ose përpunimi i të dhënave personale në lidhje me aktivitetet kriminale të përmendura në nenin 10, dhe nuk ka gjasa të rezultojë në rrezik për të drejtat dhe liritë e personave fizikë, duke marrë parasysh natyrën, kontekstin, qëllimin dhe qëllimet e përpunimit; ose

•(b) një autoritet ose organ publik.

